Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZ
Nr. 299/19
Datë/Datum. 21.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **KK-Vushtrri** OE ankues: **"Er-Lis"&"Eing shpk"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Teuta Krasniqi Eksperte profesionale e prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me : ***Nr.* 299/19** të parashtruar nga **"Er-Lis"&"Eing shpk"-Pejë**		
Datë	21. 06. 2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me: Ankesën parashtruar me dt:10.06.2019 me ***Nr.* 299/19** nga **"Er-Lis"&"Eing shpk"- Pejë** .Për shqyrtimin e lëndës **"Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal: me nr.prokurimit:644-18-8683-121**,dhe me nr te brendeshem te prokurimit: **644-18-227-121** e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK-Vushtrri**.
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.
Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KK-Vushtrri**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Er-Lis &"Eing shpk"- Pejë**

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	10.06.2019	**12.06.2019**	**21.06.2019**
Nënshkrimi i ekspertit	*data e autorizimit të ekspertit.*	*Data e fillimit të ekspertizës*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 10.06.2019 Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **299/2019** kundër Njoftimit për Dhënie të Kontratës nga OE **"Er-Lis"&"Eing shpk"- Vushtrri " lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal"me numer te E-prokurimit: 644-18-8683-121 dhe me numër të prokurimit te brendshem: 644-18-227-121** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **"KK-Vushtrri "**

Konform nenit 113 dhe nenit 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 të Prokurimit Publik të Kosovës, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK)- **"Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal"**

Operatori Ekonomik Ankues "Er-Lis"&"Eing shpk"- Vushtrri

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues **"Er-Lis"&"Eing shpk"- Vushtrri** janë:

- Neni 7- Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim;
- Neni 26.8 -Rregulloreve dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik
- Neni 67 - i LPP-së Provat Shkresore;
- Rregullat dhe udhëzuesi operativ për Prokurimin Publik Neni 24 parg 10
- Neni 105- Kompetencat e OSHP-s parag. 2.10,2.12. dhe 2.16 të LPP-së

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

ANKESA nr. 299/2019

OE i propozuar për kontratë ne Vendimin e 32/19dhe 126/19 është sqaruar se nuk është I përgjegjeshem e po ashtu edhe në Sqarimet e KRPP-së dat 19.03.2019

SQARIM:

Ak ka ngarkuar Dosjen e tenderit LISTEN E STANDARTIZUAR TE ÇMIMEVE ne pajtim me ,RREGULLAT dhe Udhzuësi operativ për prokurim Publik

Sips Nenit 24 paragrafi 10 te AK ka ngarkuar : Lista e çmimeve e standardizuar është një Liste e çmimeve që gjenerohet nga sistemi dhe përmban elemente të paracaktuara të Listes se çmimeve. Kjo Liste e çmimeve shkarkohet nga faqja e internetit të Prokurimit Publik Elektronik në Kosovë. Lista e çmimeve e standardizuar gjenerohet në formë të standardizuar të Excel-it ose kjo liste mund te plotësohet direkt në formen e sistemit ose, ne rast se kjo e liste e standardizuar nuk i plotëson nevojat (specifikat e ndryshme) e AK mund të krijoj një liste te re. Pas plotësimit dhe ngarkimit, Lista e çmimeve e standardizuar shndërrohet në një format të Listës se çmimeve e cila është e përshtatshme për tenderuesit, **me fusha të mbyllura** të përcaktuara nga autoriteti kontraktues dhe me fushat e shënuara për tu plotësuar nga ofertuesit:

1. Çmim për njësi 2.Norma e TVSH-së 3.Emri iprodhuesit 4.Shenimi i ofertuesit

Duke saktësuar detalishtë në Dosjen e Tenderit:

Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin ~~0%, 8% apo 1~~8%, Ndërsa në koionën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH. çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presjes dhjetore,,,

KU RSE:

OE i propozuar per kontrate ka plotësuar gabim Listene e Çmimeve duke plotesuar GABIM FUSHAT ne Listen e Standardizuar të Çmimeve dhe atë duke dekoduar fushat të cilat AK I ka bllokuar(me formula) ne programin EXEL, fakt të cilin për Çudi e pranon edhe Autoriteti Kontraktues.

Prandaj duke u bazuar ne LPP-ne se Lista e Çmimeve është pjesa Kryesore e Tenderit dhe me qëllim të sqarimit sa më të drejt të kam bere pytje në KRPP te me dat 19.03.2019

Pytja drejtuar KRPP se... dat 19.03.2019

Nese, Autoriteti Kontraktues ngarkon listen e Standardizuar te Çmimeve ne EXEL ne pajtim me: RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIVpër PROKURIMIN PUBLIK-Nen24pa 10 dhe Nëse, Operatori Ekonomik e ploteson gabim Listen e Çmimeve, nese "dekodon-ploteson fushat e mbyllura te percaktuara nga AK), a duhet te vleresohet si oferte e pergjegjshme nga Autoriteti Kontraktues, duke e diturse gabimi eshte teknik?

Përqiiqje: dat 27.03.2019

---Për të ndihmuar autoritetin kontraktues në vlerësimin e tenderëve, në nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, është dhëna tabela në të cilën është shtruar "problemi" dhe zgjidhja "si të veprohet?".....

Sipas tabelës së lartcekur, nëse Formulari i Tenderit nuk është plotësuar si duhet dhe/ose Lista e çmimeve, refuzohet tenderi pa kërkuar sqarime shtesë.

Sistemi Elektronik i Prokurimit Publik lejon mundësinë që edhe njëherë të kontrollohet nëse është plotësuar si duhet: Formulari i tenderit, Lista e çmimeve dhe çdo dokument tjetër që përbënë ofertën, para se ajo të ngritet në sistem.

Për të gjithë OE-të që pretendojnë se AK nuk ka vlerësuar tenderët në përputhshmëri me kërkesat këtij ligji dhe legjislacionit dytësor, si dhe në përputhshmëri me kërkesat e parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, LPP ka paraparë mjetet juridike për t'i atakuar vendimet e AK-së (nenit 108/A dhe 109 të LPP-së).

2. OE ka dorëzuar listen e punëtorëve të përhershëm (ne origjinal) JO-të vertetë(te rrejshme) në kundërshtim me Deklaraten nën betim kurse:

Neni 67 i LPP-se sqaron citoj:

KRPP përgatit dhe miraton rregullat lidhur me llojet e dokumenteve, provave dhe/ose deklaratave që operatori ekonomik duhet ti paraqes për të dëshmuar se ai nuk është i përjashtuar sipas dispozitave të nenit 65 të këtij ligji. KRPP-ja po ashtu duhet të përgatisë dhe miratojë rregulla për llojet e dokumentacionit që autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga një operator ekonomik për të dëshmuar përshtatshmërinë e tij profesionale sipas nenit 66 të këtij ligji. KRPP-ja duhet të sigurojë që sipas rregullave në fjalë të mos kërkohet rreptësisht paraqitja e dokumente ose deklarata që nuk janë në dispozicion në vende ose rajone të caktuara. KRPP-ja duhet të sigurojë që rregullat në fjalë në masë të arsyeshme tu lejojnë operatorëve ekonomik paraqitjen e deklaratave nën betim, deklaratave të noterizuara e të ngjashme. ***Në të gjitha rastet, nga operatori ekonomik kërkohet që të pranojë mundësinë e sanksionimit të tii penal dhe civil si dhe përgjegjësinë e tij për dënimet dhe dëmet, nëse operatori ekonomik me dashje ose nga pakujdesia paraqet një dokument, deklaratë ose raport materialisht të pasaktë ose mashtrues.***

OE në listen e Stafit udheheqës e ka renditur edhe nje ing te komunikacionit si punëtor të përhershem dhe atë me kontratë dhe me CV kurse ING ne fjale është punetor I përhershem në KK GJAKOVË

Prandaj besoj qe Vendimi 32/19.126/19.sqarimet e KRPP-së jan provate mjaftueshme se OE ka bërë lëshime të mëdha sa i përket plotesimit te Dosjes se tenderit.

PROPOZIM

I. **APROVOJ** - si të bazuar Ankesen, pasi që Pretendimet jane GJYKUAR në Vendimin 32/19 dhe 126/19 dhe ne sqarimet e KRPP-se

II. **ANULOHET** vendimi - për Dhenje te Kontrates AK, Komuna Vushtrri, aktivitetin e Prokurimit: Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal ta kthej në Rivleresim dhe të na shpërblej me kontratë,pasi pasi që i plotësojm të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit

III Të përdorë autoritetin në bazëtë Neni 105 neni 2.10,2.12 të LPP-së

8. **Demet materiale**

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t 'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kriteret për vlerësim:

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L- 092 , Neni 65 ;

Kërkesa 2: Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të Operatorit Ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit ;

Kërkesa 3:Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush " Kërkesat e Përshtatshmërisë " neni 6 pika 6.3 e dosjes së tenderit me datë jo më shumë se 3 (tre) muaj nga data e dorëzimit të tenderit)

Kërkesa 4. Të ketë të kryer Tatimin në Pronë në emër të themeluesit të Operatorit Ekonomik, që përfshinë periudhën deri më dt. 30.06.2018

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Evidenca 1: Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson Kërkesat për të konkuruar sipas Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, Neni 65, duke përdorur formën në Aneksin 2 të Dosjes Tenderit, duhet të dorëzohet në (Origjinal) Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë qe kërkohen nga tenderuesi qe propozohet qe te shpërblehet me kontrate dhe dorëzohen te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie te Kontratës.

Evidenca 2: Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Ju nuk jeni në vonesë për pagimin e tatimeve, ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e hapjes së këtij aktiviteti,) (duhet dorëzohet nga Op.

Evidenca 3: Një vërtetim nga " regjistri gjyqësorë " apo në mungesë të tij një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit të themlimit tuaj , që vërteton se operatori ekonomik ka të drejtë që të merrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe se ndaj tij nuk ekziston ndonjë rrethanë e përcaktuar me Nenin 65 paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së (duhet dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës (Origjinal ose kopje e vërtetuar)

Evidenca 4: Vërtetimi i lëshuar nga organi komunal me të cilin vërtetohet se është kryer obligimi mbi

Tatimin ne Prone deri më dt. 30.06.2018(duhet dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës) (Origjinal) Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentet e kërkuara në pikat, 2, 3 dhe4 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është i renditur ne vendin e dytë e kështu me radhe.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit;
Kërkesa 2.Regjistrimi i TVSH:
Kërkesa 3.Regjistrimi i Numrit Fiskal:

Dëshmia e kërkuar dokumentare
Evidenca 1: Qertifikata e regjistrimit te bisnesit me (Kopje)
Evidenca 2: Certifikata e numrit fiskal(kopje)
Evidenca 3:Qertefikata e TVSH së(kopje)

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kerkesa 1: Operatori Ekonomik, duhet të na ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një (1) furnizim të ngjajshëm gjatë 3 viteve të fundit(para datës së publikimit të njoftimit për kontratë).

Kerkesa 2: Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit Tuaj udhëheqës dhe, në veçanti, të personit përgjegjës që drejtpërdrejtë është përgjegjës për realizimin e projektit të furnizimeve dhe, minimum : 1 (Një) minimum bachelor i Komunikacionit, në detyrë të menaxherit të projektit, përgjegjës i drejtpërdrejt për ekzekutimin e projektit, së paku tri vite përvojë pune në punë të ngjashme

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Deshmia 1: Lista e projekteve të ngjashme të përfunduara në tre vitet e fundit në origjinal e vulosur dhe e nënshkruar e pasuar me së paku një referencë apo çertifikat ose raport të pranimit të kryerjes së furnizimeve të ngjashme e cila duhet të tregoj vlerën , natyrën e furnizimit dhe autoritetin kontrakëtues apo personin privat për të cilin janë kryer furnizimet , duhet dorëzuar në (kopje)

Deshmia2: Të dëshmohet diploma për përgatitjen profesionale të bachelorit, e cila duhet të jetë kopje e vërtetuar, si dhe Parakontrata apo Kontrata e Punës e nënshkruar nga Punëdhënësi dhe Punëmarrësi dhe e vulosur nga Punëdhënësi,

Procesi i prokurimit:

Data e publikimit te njoftimit për kontratë.....06.11.2018

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Vlera e parashikuar e kontratës:..... .....70.094,00 €

Kriteri për dhënie të kontratës... tenderi i përgjegjshëm me çmim më të Iirë

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....30.11.2018 ora 14:00

Data e hapjes së ofertave.....30.11.2018,ora14:00

Kerkes për qasje ne dokumente zyrtare 08.01.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim.....08.01. 2019

Data e njofitimit me letrën standarde 31.12.2018

Data e parashtrimit te ankesës në OSHP.....21.01.2019

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim. 10.01.2019

Vendimi i OSHP-Së nr .32/18 .....20.02.2019

Leter Standarte për tenderusin e Eleminuar 07.03.2019

Kerkes për rishqyrtim dat:.....11.03.2019

Vendimi i AK ne Kërkesen për Rivlersim dat:.....15.03.2019

Data e parashtrimit te ankesës në OSHP.....02.05.2019

Leter Standarte për tenderusin e Eleminuar 23.05.2019

Vendimi i AK ne per dhenje te kontratës :.....23.05.2019

Kerkes për rishqyrtim dat:.....27.05.2019

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1.	ER-LIS SH.P.K-N.N.T. EING COM	PEJ	69.974,90 €	JO
2.	"KROSA traffic signs"	FERIZAJ	39.763,19 €	JO
3.	N.P.G."Malsia"	ISTOG	66.248,56 €	JO

Komisioni i Ri-vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.
Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Fatmir Shala – Kryetar i komisionit
- Ramiz Maliqi – Anëtar i komisionit
- Isa Latifi – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues

Komisioni i Rivlersues i osertave konstaton se marr parasysh rezultatin nga procesi i rivlerësimit si dhe duke marr per baz se është detyr dhe obligim i A,K.qe te menagjoi sa ma mire me buxhetin e saj respektivisht me paran publike,te marre per bazë qe per rekomandim me kontrat e te bazohet ne kriterin e vlersimit "Tenderi i përgjegjshëm me qmimin me te lir".

Andaj në baz të karakteristikave dhe kritereve vlerësuese të tendërve të përgjegjëshem.
-Konform kriterit për dhënje të kontratës të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit ,
-duke pasur parasysh dhe kriterin e vlersimit të përmbushjes sa me së miri te kritereve për dhënjen e kontratës të specifikuara në njoftim për kontrat dhe në Dosjen e tenderit të secilit prej tenderuesve të përgjegjëshem,
-duke pasur parasysh treguesit e çmimeve të tenderuesve ,dhe kriterit për dhënje të kontratës se Tenderues fitues është ai qe ka ofruar çmimin më te ulët.
Si dhe duke marrë parasysh se edhe në procesin e Rivlersimit te ofertave O.E."Krosa traffic signs"sh,p,k. Ka ofruar garance të besueshme se kontrata do te realizohet me sukses dhe në pajtim me kushtet e saja dhe specifikat teknike ,Komisioni Rivlersues i ofertave rekomandon për kontratë te shpërblehet Operatori Ekonomik **"NPG"Malsia "-Pejë.**

1." ER-LIS SH.P.K-N.N.T. EING COM "- Në bazë të dokumenteve të kërkuara në njoftimin për kontratë dhe në DT ,Ju i plotsini te gjitha kushtet e parapara ne njoftim per kontrat dhe ne dosjen e tenderit si nga aspekti tekik ashtu edhe financiar, mir po jeni shpallë i pasukseseshëm.
2" KROS"- Organi Shqyrtues i Prokurimit ne tekstin e metejmë (OSHP) në Vendimin e tij nr,126-119 dt. 02.05.2019 i marrë në procedurën e shqyrtimit të ankesës së Grupit të O.E. :" ER-LIS"sh.p.k. & NNT ' Eing Com" - Pejë, më tej (Ankuesi) ka aprovuar ankesën e Ankuesit në fjalë, ka anuluar Njoftimin e A.K. për Dhënie Kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë, ndërsa në Vendimin e tij në mes tjerash ka obliguar

Autoritetin Kontraktues, më tej (A.K.) që të analizoi edhe njëherë disa qmime të artikujve të ofertës Tuaj që kan të bjënë me qmime prej 0.15€, 0,20€,2.00€ dhe të ngjashme. Mbi këte bazë A.K (ka bërë edhe njëherë Rivlerësimin e tenderëve të pranuar. NE pajtim me rekomandimin e OSHP-së, A.K. respektivisht Komisioni për Rivlerësimin e tenderëve ka ndërmarrd aktivitetet duke bërë hulumtimin e tregut për të përcaktuar qmimet e përafërta të furnizimeve dhe / ose shërbimeve për disa artikuj të cilat ishin Lëndë e interesit të A.K. respektivisht të cilat ishin saktësuar në Paramasë dhe Parallogari, pjesë e Dosjes së Tenderit. Kështu, më dt. 10.05. 2019 A.K. i është drejtuar Departamentit për Infrastrukturë pranë Ministris për Infrastrukturë dhe Transport me kërkesë që të na informoi lidhur me qmimet referente të disa artikujve të cilët janë objekt i shqyrtimit të A.K. Pas marrjes së informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara prej ministrisë më dt. 13.05.2019, Komisioni i Rivlerdsimit të tenderdve i ka vlerësuar me kujdes qmimet e ofruara prej tyre, duke i krahasuar edhe me qmimet e Juaja si dhe të dy O.E. tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe bazuar në të dhënat nga analiza e bërë ka ardhur në konkludim se qmimet e Juaja për disa artikuj jo normalisht te ulët në raport me qmimet e artikujve te njejtë të ofruar nga ministria si dhe të O.E tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit ,pavarësisht shpjegimeve të ofruara prej juve lidhur me ekonominë dhe procesin e prodhimit,të rrethanave të favorshme në dispozicion të juajin apo zgjithjeve teknike që juve ju favorizon në raport me O.E. tjerë në përmbushjen e kontratës.

Analiza e bërë nga A. K. ka vërtetuar se qmimet e tenderit të OE , në pozicione - artikuj të caktuar, jand jo normalisht të ulëta.

Nëse qmimeve të ofertës Tuaj i shtohen edhe llogaritjet e shpenzimeve tjera vartëse të domosdoshme sikurse janë pagesa e tatimeve dhe kontributeve ndaj ATK-së si kategori ligiore, shpenzimet vartëse si pagat për të punësuarit, transporti, montimi, e të ngiashme, të cilat vërehet se nuk janë marrë në konsideratd prej O.E, atëherë padiskutueshëm mundë të vijmë në përfundim se qmimet e ofertës Tuaj për artikuj të saktësuar si më poshtë janë jo normalisht të ulëta. Me këto qmime të artikujve të identifikuar si më poshtë në pasqyrë, A.K. nuk ka siguri se Ju do ta përmbushni kontratdën me sukses përkundër rritjes prej Juve të Sigurimit të Ekzekutimit të Kontratës prej 10% në 30%, artikujt e porositur nuk do të jenë cilësorë dhe me përshtatshmëri të dëshiruar dhe / ose kërkuar.

Andaj, duke marrë për bazë gjitha argumente sikurse u theksuan më lartë, në pajtim me nenin 61 pika të Ligiit Nr. 04lL-042 për Prokurimin Publik të Republikds se Kosovës, i ndryshuar dhe plotesuar me ligiin Nr. 04lL-237,ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligiin Nr. 05/L-092 duke mare parasysh dhe dispozitat e nenit 4 paragrafi 4.5 pika 4.5.1, Rregullave për Tenderët Jo normalisht te ulët, në pajtim me nenin 4 paragrafi 4.6 pika 4.6.2 të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të ulët kemi vendosur që tenderi i O.E. të refuzohet.

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë/është:

Nr	EMRI I OPERATORËVE EKONOMIK QË KANË DORËZUAR TENDER TE PËRGJEGJSHËM	Vendi	Çmimi €	Radhitja
1.	N.P.G."Malsia"	ISTOG	66.248,56 €	1
2.	ER-LIS SH.P.K-N.N.T. EING COM	PEJ	69.974,90 €	2

Komisioni i Ri-vlersimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardhë në përfundim se nga tre OE qe kan ofertu kemi dy oferta të përgjegjshëm dhe kanë rekomanduar për kontratë **N.P.G."Malsia"-ISTOG,** , me çmimme te lirë prej: 66.974,56€ dhe ky rekomandim nga komisioni i vlersimit është aprovuar nga menagjeri i prokurimit .

Ofertat e pa përgjegjshëm që nuk i kanë plotësuar kërkesat sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi me TVSh në hapje
1	"KROSA traffic signs"	Ferizaj	39.763,19 €

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

OE.ankues"Er-Lis"&"Eing shpk"- Vushtrri"-pretendon se Kuvendi Komunal i Vushtrri nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së,ky nen është shkelur pasi qe AK-ja nuk i ka vlerësu të gjithë OE njësoj ,sipas OE ankues.

Qëllimi i nenit 7 të LPP-së është që AK. ti trajtojë Operatoret ekonomik në menyrë të barabartë,pa diskriminim dhe në menyrë transparente .

AK-së gjatë Ri-vlerësimit Operatorin Ekonomik ankues , e ka trajtuar si OE. të pasuksesëshëm ngase nuk ishte tenderi me çmim më të lirë ,duke sqaruar se ishte ofertë që i plotson të gjitha kriteret e parapara me NJ.K. dhe dosjen e tenderit.

Sa i perket pretendimit të OE.ankues , se AK-së e ka trajtuar OE.Malësia si OE i pergjegjëshëm dhe e ka rekomandua për shpërblim me kontratë dhe se njëjti nuk është i pergjegjëshëm sipas OE ankues ,ky pretendim është i bazuar dhe arsyet e pranimit të këtij pretendimi i gjeni te pergjigjeja nr. 2
Andaj ,
Ekspertja konstaton se pretendimi i OE.ankues qendron dhe i njejti është i pjesërisht i bazuarë .

Përgjigje në Pretendimi nr.2
OE.ankues"Er-Lis"&"Eing shpk"- Vushtrri"- pretendon se Kuvendi Komunal i Vushtrri nuk ka respektuar nenin 24.10 dhe neni 26.8 te Rregullat e Udhzuesit Operativ të Prokurimit Publik ,sipas OE.ankues.

Qellimi i nenit 24.10 është të rregullohet mënyra e Listes së çmimeve që gjenerohet në sistem dhe rregullat se si duhet të plotësohet dhe neni 26.8 ka për qellim të sqaroj lidhur me kriteret e përzgjedhjes që mund të përdorën nga AK-së e te cilat janë të vendosura në NJ.K. dhe në D.T.

Sips Nenit 24 paragrafi 10 te AK ka ngarkuar : Lista e çmimeve e standardizuar është një Liste e çmimeve që gjenerohetn nga sistemi dhe përmban elemente të paracaktuara të Listes se çmimeve. Kjo Liste e çmimeve shkarkohet nga faqja e intemetit të Prokurimit Publik Elektronik në Kosovë. Lista e çmimeve e standardizuar gjenerohet në formë të standardizuar të Excel-it ose kjo liste mund te plotësohet direkt në formen e sistemit ose, ne rast se kjo e liste e standardizuar nuk i plotëson nevojat (specifikat e ndyshme) e AK, AK mund të krijoj një liste te re. Pas plotësimit dhe ngarkimit, Lista e çmimeve e standardizuar shndërrohet në njëformat të Listës se çmimeve e cila është e përshtatshme për tenderuesit, me fusha të **mbyllura** të përcaktuara nga autoriteti kontraktues dhe me fushat e shënuara për tu plotësuar nga ofertuesit:

1.Çmimpër njësi 2.Norma e TVSH-së 3.Emri iprodhuesit 4.Shënimi i Ofertuesit **,sipas OE ankues**

Ekspertja shqyrtuese konstaton, se Dallimi i gabimit aritmetik e tejkalon normën e lejuar +, - 2% duke u bazuar në Nenin 59 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ,

Ekspertja e prokurimit ka kalkuluar vetem 4 pozicione si me ekspertizën paraprake dhe është vertetuarë se ka gabime në kalkulim mbi normen e lejuar andaj edhe konstaton se AK. me rastin e Ri-vlerësimit gabimisht i ka ndryshuar çmimet për njësi prap po i përmendi vetëm 4 pozicionet e para ku OE .ka ofertuarë me këto çmime për njësi si në tabel :

Operatori Ekonomik :Malsija NPTGN.									
Nr.	Përshkrimi I pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi € (pa tvsh)	TVSH (%)	Çmimi njësi me TVSH €	Çmimi total me TVSH € (I llogaritur nga Ekspertja e Prokurimit)	Çmimi total me TVSH € (I dhënë nga OE) dhe Komisioni I Rivlersimit	Ndryshimi I totalit të çmimit
1	A1- Vijë e plotë e panderprerë b=120mm	m	3800	1.79	0.32	2.11	8,026.36	6,840.00	1,186.36
2	A2 vijë e nderprerë b=120mm(e mesit)	m	7200	0.90	0.16	1.06	7,646.40	6,480.00	1,166.40
3	A3 Vendkalim të kombësorve (me para-vijëzim)	m	580	7.89	1.42	9.31	5,399.92	4,640.00	759.92
4	A4 -Shenja tërthore në rrugë (vijë e ndalimit) me gjerësi 500mm	m	72	7.89	1.42	9.31	670.33	156.00	514.33
Totali i Përgjithshëm							21,743.01	18,116.00	3,627.01

Totali I pergjithshem I dhene nga OE	18,116.00
Dallimi ne kalkulim OE-Komisioni I Ri vlersimit(vetem per 4 pozicione)	(3,627.01)
Norma e lejuar e gabimit aritmetik (per 4 pozicione)	2%
	362.32

Konstatim: Dallimi i gabimit aritmetik e tejkalon normën e lejuar +, - 2% Duke u bazuar në Nenin 59 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 , Ekspertja e prokurimit ka kalkuluar vetem 4 pozicione dhe është vertetuar se ka gabime në kalkulim mbi normen e lejuar andaj edhe konstaton se AK-së me rastin e Ri-vlerësimit gabimisht i ka kalkuluar çmimet e OE .Malësija ,Tabela e kalkulimeve që gjindet në shkresat e lendes është e nenshkruar nga antaret e komisionit.

Kurse Ak-së-Komisioni i vlerësimit i ka ndryshuar **çmimet për njësi** duke ia përshtatur totalit të ofertës dhe AK-së gabimisht pretendon se ka gabime vetëm në TVSH. dhe për të njëjtat nuk vlen rregulla +- 2% ,sikur të ishte gabimi vetëm në tvsh .do ishte në rregull dhe te njëjtat nuk do kishin paraqitur problem sepse është e qart dhe për të njëjtin qështje jo vetëm se ka jep interpretim KRPP.ja por ajo qështje është e gjykar sepse ka vendim nga OSHP.ja që gabimet në TVSH . i ka trajtur si gabime që nuk hyjn te rregulli +-2%, .

Mirëpo rasti i juajë hyn te gabimet në kalkulim sepse e tejkalojn normën e lejuar dhe ju si AK-së nuk keni të drejt ti ndryshoni çmimet për njësi siq keni vepruar shih se si i keni ndryshuar çmimet për njësi po i shkruaj vetëm 4 pozicionet e para kurse ju i keni ndryshuar te gjitha njësit :

Pozicioni 1 çmimi për njësi në vend të çmimit 1.79 ju e keni ndryshuar në çmim 1.53
Pozicioni 2 çmimi për njësi në vend të çmimit 0.90 ju e keni ndryshuar në çmim 0.76
Pozicioni 3 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 ju e keni ndryshuar në çmim 6.78
Pozicioni 4 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 ju e keni ndryshuar në çmim 6.78

Keshtu keni vepruar në të gjitha njësit dhe gabimisht e keni ndryshuar tërë ofertën .

Kjo menyrë e vlerësimit bjen në kundërshtim me paragrafin 41.10 pika b të nenit 41 të RRUOPP. Ekzaminimi ,vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve ,ku ekskluzivisht e rregullon ketë qeshtje te njëjtin normë po e citoj si :

„Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet .Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmim për njësi ,tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr''

Andaj mbi këtë bazë Ekspertja shqyrtuese konstaton se pretendimi është i bazuarë .

<u>Përgjigje në Pretendimi nr.3</u>

OE ankues**"Er-Lis"shpk.&" N.N.T Eing com "-Pejë,** pretendon se Kuvendi Komunal Vushtrri nuk e ka respektuar Neni 67 të LPP-së Provat shkresore .

OE .ankues pretendon se dokumentacioni i ofruar është në kundërshtim me qëllimin e këtij neni i cili ka per qellim qe deklaratat dhe dokumentacioni i ofruar duhet të jetë nën betim dhe qdohere ofertuesi mban përgjegjësi si nga aspekti penal dhe civil.

Sa i perket këtij pretendimi ekspertja sqaron se nuk është nënë kompetencat e mia sepse për këto pretendim janë organet tjera kompetente ,kurse unë kam kompetencë vetëm të sqaroj se a egziston apo jo dokumenti meqë egzistenca e dokumentit nuk është kontestuese.

Ekspertja shqyrtuese konstaton se ky pretendim është i pa bazuarë .

<u>Përgjigje në Pretendimi nr.4</u>

OE ankues**"Er-Lis"shpk.&" N.N.T Eing com "-Pejë,** pretendon se Kuvendi Komunal Vushtrri nuk e ka respektuar Neni 105 të LPP-së Kompetencat e OSHP-së par.2.10-2.12-dhe 2.16 të LPP-së

AK-së pas pranimit të vendimit OSHP.së me nr .126/19 të dt. 02.05.2019 gjegjësisht të Panelit Shqyrtues, konform par.1 të nenit 59 të LPP.së ka themeluar komision për Rivlersimin ekzaminim dhe krahasimin e ofertave dhe i njejti siq parashihet me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP.së

Andaj,

Ekspertja shqyrtuese konstaton se ky pretendim është i pa bazuarë .

Mendimi i ekspertes shqyrtuese

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura,ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e lartpërmendur të operatorit ekonomik ankues ta aprovoj si të BAZUARË (për arsyen që u cekën ma lart),dhe rekomandon që lënda të kthehet në Ri-vlerësim .